



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. 73/78 Prot.

Tiranë, më 12.10.2023

V E N D I M

Nr. 10, datë 12.10.2023

PËR

***“NJË NDRYSHIM NË VKD NR. 3 DATË 25.05.2023 “PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIME INDIVIDUALE TË SIPËRMARRËSIT ONE ALBANIA SH.A, PËR
PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZAVE 900 MHZ, 1800 MHZ DHE 2100
MHZ, PËR SHKAK TË RISHPËRNDARJES, ME QËLLIM SIGURIMIN E
PËRDORIMIT EFIÇENT TË KËTYRE FREKUENCAVE””***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 12.10.2023, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Autorizimeve dhe Drejtorisë Teknike shqyrtoi kërkesën me objekt:

“Për një ndryshim në VKD nr. 3 datë 25.05.2023 “Për pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efiçent të këtyre frekuencave””.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja c e pikës 1 dhe pika 2, e nenit 75, të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH” (Ligji nr.44/2015);
3. Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar.

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a dhe One Albania sh.a, me shkresat e përbashkëta me nr. 73/53 prot., datë 09.03.2023 dhe nr. 73/59 prot. datë 15.05.2023, kanë kërkuar rishpërndarjen e frekuencave të secilit nga brezat e 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, me qëllim përdorimin me efikasitet të këtyre frekuencave, si dhe kanë paraqitur një propozim sipas një ndarje të dakordësuar midis tyre për rishpërndarjen e secilit nga brezat, në dy pjesë, për të eliminuar ndarjen aktuale me disa pjesë.
Në vijim të kërkesës së tyre AKEP, me Vendimin nr. 3 datë 25.05.2023, ka vendosur pajisjen me autorizime individuale të sipërmarrësit One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, për shkak të rishpërndarjes, me qëllim sigurimin e përdorimit efikasitet të këtyre frekuencave”.
2. Rishpërndarja e spektrit, duke ruajtur të njëjtën sasi spektri të caktuar më parë për secilin operator dhe pa ndryshuar afatet e vlefshmërisë të përdorimit të secilit spektër, liroi sasi spektri të konsiderueshme, në secilin prej brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, gjë e cila përbën përfitim me interes publik.
3. Në vijim të miratimit të vendimit të cituar më sipër, AKEP pajisi me autorizime individuale sipërmarrësin One Albania sh.a, për përdorimin e frekuencave të brezave 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz, sipas Aneksive bashkëlidhur vendimit.
4. Gjatë verifikimeve periodike të strukturave të AKEP që merren me administrimin dhe autorizimin e frekuencave, është vënë re që tabelat e Aneksit 2 dhe Aneksit 3 të këtij vendimi, kanë nevojë për disa saktësime në afatet kohore. për një pjesë të spektrit 1800 MHz dhe një pjesë të spektrit 2100 MHz. Këto saktësime, konsistojnë në pasqyrimin e saktë të pjesëve të këtyre spektrave sipas afateve respektive, siç janë miratuar në vendime të mëparshme nga AKEP, pa ndryshuar sasinë totale të këtyre spektrave të këtij operatori.
Konkretisht:
 - në tabelën e aneksi 2 të VKD nr. 3 datë 25.05.2023, rezulton një sasi spektri prej 4.5 MHz e brezit 1800 MHz, e cila ka mbetur gabimisht në këtë tabelë, sepse është transferuar tek sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, miratuar me VKD nr. 15 datë 16.12.2022 “Për miratimin e transferimit të të drejtave të përdorimit të disa frekuencave nga sipërmarrësit “Albtelecom sh.a” dhe “One Telecommunications sh.a” tek sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a”. Për këtë arsye, kjo tabelë nuk duhet të jetë në këtë aneks dhe nga heqja e saj sistemohen dhe saktësohen pjesët vijuese të spektrit 1800 MHz të One Albania sh.a, sipas sasive dhe afateve respektive, të miratuara nga AKEP me VKD nr. 2552 datë 10.04.2015, VKD nr. 2553 datë 10.04.2015 dhe VKD nr. 15 datë 16.12.2022.
 - në tabelën e aneksi 3 të VKD nr. 3 datë 25.05.2023, ka nevojë të saktësohet një sasi spektri prej 5 MHz në brezin 2100 MHz është me afat vlefshmërie 01.04.2031, e cila gjendet në tabelë e pasqyruar për shkak të marrëveshjes për transferim spektri, mes

operatorëve One Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a, paraqitur në AKEP me shkresat e përbashkëta nr. 5075/5 prot., datë 13.12.2022, nr. prot. 5159/6 prot. datë 13.12.2022 dhe nr. 73/24 prot. datë 14/12/2022, miratuar nga AKEP me VKD nr. 15 datë 16.12.2022. Pas riverifikimeve të marrëveshjes teknike të operatorëve për rishpërndarjen e spektrit për përdorim maksimal eficient të tij, paraqitur në AKEP me shkresat nr. 73/53 prot. datë 09.03.2023 dhe nr. 73/59 prot. datë 15.05.2023, rezulton se sasia 5 MHz e kaluar nga One Albania sh.a tek Vodafone Albania sh.a, për të garantuar vijueshmëri në këtë spektër, është sasia 5 MHz me afat vlefshmërie 30.10.2026 dhe jo sasia 5 MHz afat vlefshmërie 01.04.2031, e tabelës aktuale të aneksit 3, të VKD nr. 3 datë 25.05.2023.

5. Nga këto saktësime, sasia totale e spektrit të alokuar në këtyre operatorëve në brezat 1800 MHz dhe 2100 MHz, nuk ndryshon. Gjithashtu, kanalet e frekuencave të liruara nga rishpërndarja e spektrit në këta breza (0,4 MHz në brezin 1800 MHz dhe 0,4 MHz në brezin 2100 MHz) dhe pozicioni i tyre në spektër, nuk ndryshojnë dhe mbeten të njëjtët, siç janë përcaktuar në VKD nr. 3 datë 25.05.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1, neni 114 dhe pikës 1, të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikës 1, të nenit 112, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke marrë në konsideratë rëndësinë që paraqet miratimi i këtij vendimi, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e anekseve 2 dhe 3 të VKD nr. 3 datë 25.05.2023, të cilët jepen të saktësuara bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Sasia totale e spektrit të alokuar One Albania sh.a në secilin nga brezat 1800 MHz dhe 2100 MHz dhe kanalet e frekuencave të liruara nga rishpërndarja e spektrit në këta breza sipas VKD nr. 3 datë 25.05.2023, nuk ndryshojnë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Autorizimeve dhe Drejtoria Teknike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Armer Juka	Bleron Dokle